

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Fibernet

RRJETË FIBRASH QELQI E VESHUR DHE ME REZISTENCË NDAJ ALKALEVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Fibernet është rrjetë fibrash qelqi, e pajisur me veshje rezistuese ndaj alkaleve që përdoret për përf forcimin e llaçeve të çimentos, allçive, suvave, etj.

PËRDORIMET

Sika® Fibernet:

- 80g/m² në ngjyrë të bardhë është e përshtatshme për përf forcimin e llaçeve të çimentos, si Sikalastic® -1K, SikaTop® Seal-107 FL-X, etj.
- 110g/m² në ngjyrë blu është e përshtatshme për përf forcimin e suvave dhe allçive, si SikaDecor®-803 Nature

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ngulitet lehtë mbi suvanë
- Rezistencë ndaj alkaleve për shkak të trajtimit të sipërfaqes
- Rezistencë afatgjatë ndaj tronditjeve dhe lëvizjeve për shkak të ndryshimit të temperaturës apo tkurrjes
- Shpërndarje e njëtrajtshme e sforcimit mbi të gjithë sipërfaqen e suvasë, për parandalimin e përqëndrimit të sforcimeve dhe plasaritjeve
- Disponohet në 2 lloje në varësi të aplikimit

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ndërtimi	Forma: Rrjetë		
		Sika® Fibernet 80g/m ²	Sika® Fibernet 110g/m ²
	Ngjyra	E bardhë	Blu
	Përmasa e hapjes:	4 x 4mm	10 x 10mm
Lloji i fibrës	Fibra qelqi (E-glass), rezistuese ndaj alkaleve		
Ambalazhi		Sika® Fibernet, e bardhë	Sika® Fibernet, blu
	Gjatësi ruloni	50m	50m
	Gjerësi ruloni	100cm	25 ose 100cm
Jetëgjatësia	Sika® Fibernet nuk ka datë skadence.		
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrirja.		
Dendësia e sipërfaqes		Sika® Fibernet, e bardhë	Sika® Fibernet, blu
	Pesha e pëlhurës	min. 66g/m ²	min. 88g/m ²
	Pesha e përfunduar	min. 80g/m ²	min. 110g/m ²

TË DHËNA TEKNIKE

Trashësia nominale e fletës	Sika® Fibernet 80g/m ²	Sika® Fibernet 110g/m ²	
	min. 0.40mm	min. 0.43mm	
Zgjatimi deri në thyerje	Originale:	Sika® Fibernet, e bardhë	Sika® Fibernet, blu
	Baza (gjatësore)	2.9%	3.6%
	Fija (tërthore)	3.7%	2.8%
	Pas vjetërimit:		
	Baza (gjatësore)	2.0%	2.3%
	Fija (tërthore)	2.5%	2.0%
Rezistenca ndaj tërheqjes	Originale:	Sika® Fibernet, e bardhë	Sika® Fibernet, blu
	Baza (gjatësore)	660N / 5cm	1059N / 5cm
	Fija (tërthore)	800N / 5cm	820N / 5cm
	Pas vjetërimit:		
	Baza (gjatësore)	375N / 5cm	675N / 5cm
	Fija (tërthore)	500N / 5cm	510N / 5cm

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Aplikoni një shtresë të njëtrajtshme llaçi çimentoje, si Sikalastic®-1K, SikaTop® Seal-107 FL-X, etj., suva ose allçi, si SikaDecor®-803 Nature, me mallë krëhër apo çdo lloj vegle tjetër që përcaktohet në skedën teknike të produktit. Vendosni Sika® Fibernet mbi produktin e sapoaplikuar. Gjithashtu, ushtroni presion mbi Sika® Fibernet me një shpatull për të përfunduar ngulitjen. Për të shmangur plasaritjet ndërmjet rulonave të vazhdueshëm Sika® Fibernet, siguron mbivendosje prej ≥ 10cm.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Fibernet

Dhjetor 2019, Botimi 02.01

020206020040000009

BUILDING TRUST



SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Fibernet
Dhjetor 2019, Botimi 02.01
020206020040000009

SikaFibernet-sq-AL-(12-2019)-2-1.pdf

